

NJOFTIM I NJË PËRQENDRIMI

(ProCredit Holding AG-FEFAD/IFC)

1. Në datën 10.08.2007, Autoriteti I Konkurrencës ka marrë njoftim për përqendrimin e propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sipas të cilit ndërmarrja ProCredit Holding AG (PCH AG) përfton kontrollin nga blerja të totalit prej 36.25% të aksioneve (respektivisht 25% dhe 11.25% të zotëruara nga FEFAD dhe IFC) në ProCredit Bank Sh.A. Ky transaksion, sipas marrëveshjes për blerjen e aksioneve, nënshkruar nga palët pjesëmarrëse është kryer në datën 08 Qershor 2007.
2. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse është:
 - Për ndërmarrjen ProCredit Holding AG: shërbime bankare
 - Për ndërmarrjen FEFAD: nuk kryen veprimtari ekonomike, përveç pjesëmarrjes si aksioner në ProCredit Bank Sh.a
 - Për ndërmarrjen IFC: nxitja e zhvillimit ekonomik duke inkurajuar përhapjen e bizneseve prodhuese private, veçanërisht në zonat më pak të zhvilluara. Aksioner në ProCredit Bank Sh.a.
3. Nga shqyrtimi paraprak, rezulton, që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit dhe duhet t’i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të përcaktuar në Ligj dhe në Rregulloren “Për Përqendrimet e Ndërmarrjeve”.
4. Autoriteti fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4 Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.go.al.